Numër: 01/151
Datë: 18.03.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, bazuar në nenin 53, 54 paragrafi 1 pika 1.1 i Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 15.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anulohet vendimi i Këshillit Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve i marr në mbledhjen e datës 05.10.2023 për aprovimin e kërkesës së Institucionit "Sellma Academy" për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Sellma Academy" me datë 11.07.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të kualifikimit Grimer, niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP. Zyrtaret e AKK-së me datë 25.09.2023 kanë kontrolluar dosjen e aplikuesit dhe kanë përpiluar një raport me të cilin është konfirmuar gjendja se aplikacioni i plotëson kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi. Raporti është futur si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 05.10.2023 me rekomandimin për KD që ta aprovojë aplikacionin e palës aplikuese. Këshilli Drejtues duke vendosur në bazë të rekomandimeve në këtë raport se institucioni i plotëson kushtet për të hyrë në proces të akreditimit dhe validimit me vota unanime kishte aprovuar aplikacionin e këtij institucioni. Pastaj, KD kishte udhëzuar AKK që të vazhdoj me procedurat tjera sipas legjislacionit në fuqi. AKK ka caktuar ekipin vlerësues të ekspertëve me qëllim të realizimit të vizitës në këtë institucion, po ashtu është caktuar edhe data e realizimit të vizitës. Mirëpo, zv. i Drejtorit të AKK-së, gjatë komunikimeve në mes të zyrtares së AKK-së me përfaqësuesen e institucionit "Sellma Academy" për realizimin e vizitës së ekipit të ekspertëve tek ofruesi ka

kuptuar se pjesë e stafit ishte edhe z. Milot Hasangjekaj (ish zyrtar i AKK-së) dhe kishte kërkuar nga zyrtaret e AKK-së dosjen e aplikuesit me qëllim të vërtetimit nese z. Hasangjekaj ishte pjesë e stafit të "Sellma Academy".
Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, neni 10 paragrafi 1 pika 1.12. Institucioni aplikues duhet të ofroj kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhë të caktuar, si dhe neni 11 paragrafi 1 pika 1.1 Faza 1: Institucionet marrin informata dhe udhëzime nga AKK dhe zhvillojnë një vetëvlerësim bazuar në kriteret e AKK. Institucioni e paraqet aplikacionin, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionet tjera shtesë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Ndërsa, institucioni "Sellma Academy" në listën e stafit menaxhues, profesional dhe administrativ të dërguar në AKK, ka caktuar edhe z. Hasangjekaj si pjesë e stafit, mirëpo në dosjen e aplikimit ka munguar kontrata dhe CV-ja e tij, duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara nga AKK, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu, është vërejtur se në dosje ka edhe parregullsi tjera sa i përket periudhës kohore kur janë nënshkruar aneks kontratat e pjesës tjetër të stafit të ofruesit, të cilat janë nënshkruar me datë 01.09.2023, ndërsa institucioni ka aplikuar në AKK me datë 11.07.2023. Lidhur më këtë zv. Drejtori i AKK-së me datë 21.12.2023 përmes email-it ka kërkuar sqarim nga zyrtarja e AKK-së, se a është plotësuar dosja e aplikimit me ndonjë material tjetër pas dorëzimit të aplikimit, nese po me çfarë materiali dhe kur? Zyrtarja e AKK-së përmes email-it me datë 22.12.2023 ka ofruar këto të dhëna: Me datë 11.07.2023 Sellma Academy ka sjellur kërkesën bashkë me dosjen aplikuese për hyrje në proces, dosja e aplikimit nuk është plotësuar me material shtesë. Prandaj, Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 05.10.2023 ka aprovuar raportin e eksperteve të brendshëm të AKK-së pas rekomandimeve se aplikacioni i plotëson kushtet e paparapara sipas dispozitave ligjore në fuqi, pa qenë në dije se dosja e aplikuesit ka mangësi.

Bazuar në Rregulloren Nr.01/521 të datës 01.12.2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NJMP), neni 5 IAAP duhet që dosjen e tyre të aplikimit ta hartojnë në përputhje me dispozitat ligjore, Udhëzimet Administrative, standardet dhe kriteret e vendosura nga AKK.

Andaj, Këshilli Drejtues pas raportimit të zv. Drejtorit të AKK-së për shkelje procedurale, administrimit të të gjitha provave, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së, nenin 52 paragrafi 1 pika 1.3. nenin 54 paragrafi 1 pika 1.1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Bazuar në nenin 127 paragrafi 1, nenin 128 paragrafi 1, i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pala e pa kënaqur me këtë vendim ka të drejt ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, e tek organi publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Sellma Academy".
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së